



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR

www.gsa.gov.al

*Adresa:
Rruga "Zef Serembe"
Tiranë, Shqipëri*

**MODELI I RAPORTIT GJEOLGJIK QË PËRGATITET NGA
SUBJEKTET PRIVATE DHE SHTETËRORE PËR SHFRYTËZIMIN E
ZHAVORREVE NË SHTRATIN E LUMENJVE DHE PËRRENJVE NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

PËRMBAJTJA E RAPORTIT GJEOLGJIK

1. **Kopertina** (faqe më vete).

2. **Përmbajtja e lëndës** (faqe më vete).

3. **Hyrja.** (lihet në vlerësimin e autoreve të japë informacione të përgjithshme lidhur me detyrën e projektimit të ngarkuar nga subjekti)

4. **Të dhëna të përgjithshme.**

4.1. **Të dhëna mbi subjektin që ka përgatitur raportin:**

- Emri i subjektit/ shoqërisë sipas regjistrimit në QKB (Studio, Person i licencuar) që ka kryer studimin, që në këtë rast quhet Subjekti i Porositur;
- Adresa e selisë së subjektit/ shoqërisë sipas regjistrimit në QKB, Nr. telefonit/ e-mail.
- Numri dhe data e licencës profesionale të drejtuesit teknik që ka përgatitur raportin;

5. **Përshkrim i shkurtër gjeografik-ekonomik, vendndodhja administrative dhe topografike e zonës ku do të kryhet shfrytëzimi i inerteve lumore:**

- Gjeografia e zonës, relievi, klima, hidrografia, bimësia;
- Demografia, infrastruktura ekzistuese, etj.
- Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore.

6. **Të dhëna mbi territorin që kërkohet për shfrytëzim inertesh**

6.1. **Karakteristikat e vendndodhjes së objektit në raport me pjesën e rrjedhës lumore** (e poshtme, e mesme apo e sipërme, elementët kufizues të sheshit, brigje, banko apo tarraca, rruge automobilistike, argjinatura, objekte inxhinierike etj, Zhveshmeria e objektit, në vijimësi sipër dhe poshtë objektit sipas rrjedhës)

6.2. **Koordinatat e territorit që do të merret për shfrytëzim inertesh lumore, të azhornuara në hartën topografike në shkallën 1:25 000 sipas planshetit përkatës me sipërfaqe km², të projektuara në planin horizontal të pikave kufizuese sipas tabelës së mëposhtme:**

Nr. Pikës	Koordinatat	
	X	Y
1
2
n

6.2. **Gjendja e shtratit të lumit para shfrytëzimit** (përshkrim i gjendjes së shtratit të lumit me elemente morfologjik të shpatit dhe brigjeve gjelbërimi, erozioni, akumulimi)

6.3. **Pritshmëritë e ndryshimeve dinamike që vijnë nga shfrytëzimi i zonës.**(Ndikim i shfrytëzimit poshtë dhe sipër objektit sipas rrjedhës).

7. **Punimet fushore gjeologjike**

- Qëllimi dhe metodika e kryerjes së punimeve fushore gjeologjike;
- Koha e kryerjes së punimeve fushore;
- Rilevim topografik në shkallë 1: 2 000, rilevim gjeologjik në shkallë 1:2 000, volumet e punimeve në sipërfaqe m², shkalla e punimeve fushore, numri i pikave të marra gjatë

punimeve në terren me koordinatat përkatëse për çdo pikë, të dhëna mbi trashësitë e shtresave që do të shfrytëzohen me fotot përkatëse për çdo shtresë që do të shfrytëzohet të realizuara nëpërmjet kryerjes së pusëzave etj.;

- Ndërtimi i hartës gjeologjike në shkallë 1:2 000 në sektorin ku do të kryhet shfrytëzimi i inerteve;
- Ndërtimi i profilit gjatësor gjeologo - topografik në shkallë 1:2 000;
- Ndërtimi i profileve tërthor gjeologo - topografik të zonës së kërkuar për shfrytëzim në shkallë të lexueshme;
- Marrja e kampionaturës së nevojshme për analizime granulometrike, petrografike dhe mineralogjike.

8. Ndërtimi gjeologjik.

8.1. Ndërtimi gjeologjik i rajonit ku ndodhet dhe objekti i shfrytëzimit të inerteve lumore dhe inerteve të përrenjve. (Në këtë nënkapitull do të përshkruhen llojet shkëmbore që marrin pjesë në ndërtimin gjeologjik të pellgut ujëmbledhës të rrjedhës ujore ku do të kryhet aktiviteti i shfrytëzimit, nga kuotat më të larta drejt atyre kuotave më të ulëta).

- **Stratigrafia**

(Përshkrimi i stratigrafisë do të bëhet nga moshat më të vjetra deri tek ato më reja).

- **Magmatizmi** (në qoftë se vërehet prania e tyre në hartë, brenda pellgut ujëmbledhës)

(Në këtë kapitull do të përshkruhen llojet shkëmbore magmatike sipas moshës dhe sipas facieve të cilat mund të jenë vullkanike, intruzive dhe subvullkanike).

- **Metamorfizmi**

- **Tektonika**

(Në këtë kapitull do të përshkruhet qartë dhe hollësisht:

- Në cilën zonë tektonike bën pjesë territori ku do të zhvillohet aktiviteti i shfrytëzimit të inerteve lumore dhe atyre të përrenjve;
- Karakteri i marrëdhënieve të llojeve shkëmbore midis tyre;
- Shtrirja e linjave madhore dhe minore tektonike, azimuti i shtrirjes së tyre, drejtimi i veprimit të tyre;
- Linjat tektonike që takohen në territorin ku do të kryhet aktiviteti i shfrytëzimit të inerteve dhe a janë aktive apo jo në ditët e sotme dhe pasojat që ato shkaktojnë në reliev;
- Përshkrimi i strukturave antiklinale dhe sinklinale që gjejnë shtrirje në këtë territor, vargjet strukturore antiklinale dhe sinklinale etj).

8.2. Ndërtimi gjeologjik i sektorit ku do të kryhet shfrytëzimi i inerteve lumore dhe inerteve të përrenjve.

(Në përshkrimin e gjeologjisë së sektorit, stratigrafia dhe magmatizmi do të bëhet shkurt sipas skemës së përcaktuar për ndërtimin gjeologjik të rajonit). Ky kapitull do të përmbajë:

8.2.1. Të dhëna mbi ndërtimin gjeologjik të objektit (bazamentit dhe brigjeve).

8.2.2. Depozitimet kuaternare (Depozitimet inerte dhe ato mbulesore në shtrat dhe tarracat e shtratit të lumit).

9. Karakteristikat cilësore të pakos produktive.

- Të dhëna granulometrike, petrografike, mineralogjike dhe fiziko mekanike mbi inertet që do të shfrytëzohen. (me fletë analizimi nga laboratorë të liçensuar).
- Roli i alterimit fizik dhe kimik dhe ndikimi i efektit të tyre në shkatërrimin e llojeve shkëmbore që ndërtojnë gjeologjinë e territorit, copat e të cilave shërbejnë si bazë furnizimi për krijimin depozitimeve të inerteve në kohë.

10. Kushtet Gjeologo Inxhinierike (dinamika) në zonën e shfrytëzimit të inerteve lumore.

Në këtë kapitull të përshkruhen:

- Gjeodinamika e lumit;
- Erozioni i shpateve ne dy anët të lumit (gjendja e tyre para fillimit të shfrytëzimit);
- Parashikimi i qëndrueshmërisë së shpateve dhe brigjeve të lumit pas shfrytëzimit inerteve dhe mënyrat e stabilizimit tyre.

11. Kushtet hidrogjeologjike dhe ndikimi në ujërat nëntokësore.

Në këtë kapitull të përshkruhen:

- Përshkrim i akuiferit që do të kryhen punimet e shfrytëzimit;
- Të dhëna mbi pikat ujore (shpime, burime nëse ka) kaptazhet (stacionet) më të afërta me zonën e shfrytëzimit;
- Nivelet e ujërave nëntokësore;
- Ndikimi që do të kenë/pësojnë ujërat nëntokësore nga shfrytëzimi;

12. Llogaritja e rezervave gjeologjike (Metodika e llogaritjes, tabela me llogaritjet përkatëse).

13. Përfundime e rekomandime

14. Literatura

15. Materiale ilustruese në shkallë, jashtë tekstit

- *Harta gjeologjike 1:25000*
- *Harta gjeologjike e objektit 1:2000*
- *Harta topografike shkallë 1:2000*
- *Profile gjeologjike tërthore në shkallë të lexueshme*
- *Profili gjeologjik gjatësor i shtratit të lumit në zonën e shfrytëzimit*
- *Planimetria e zonës me llogaritje rezervash.*
- *Profile tërthore të llogaritjes së rezervave shkallë të lexueshme*

16. Mandat pagesat për materialet gjeologjike të shfrytëzuara nga AQTGJ i SHGJSH-së dhe shërbimin e kërkuar për oponencë.

Përgatiti: inxh. Siri Hamiti, Inxh. Mentor Lamaj, Inxh. Rushan Çako